FLETËUDHËZUES I PAKETIMIT:
Informacion për përdoruesin

CLODERM 1%

Krem – 10 mg / 1 g
Klotrimazol

Lexojeni me kujdes fletëudhëzuesin përpara se të filloni të përdorni këtë bar sepse ai përmban informacione të rëndësishme.

Përdoreni këtë bar gjithmonë ashtu siç është përshkruar në këtë fletëudhëzues ose sipas udhëzimeve të mjekut apo farmacistit tuaj.

- Ruajeni fletëudhëzuesin. Mund t'ju nevojitet ta lexoni përsëri.
- Pyesni farmacistin tuaj nëse keni nevojë për informacione të mëtejshme ose për këshillë.
- Nëse simptomat ju përkeqësohen ose nëse pas 7 ditësh nuk keni asnjë përmirësim, duhet të kontaktoni me një mjek.
- Nëse ndonjë prej efekteve anësore ju shqetëson ose nëse vini re efekte anësore që nuk përmenden në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të informoni mjekun ose farmacistin tuaj. Shikoni pikën 4.

Ky fletëudhëzues përmban:

1. Çfarë është Cloderm 1% dhe përse përdoret?
2. Çfarë duhet të kini kujdes përpara se të përdorni Cloderm 1%?
3. Si ta përdorni Cloderm 1%?
4. Cilat janë efektet anësore të mundshme?
5. Si ta ruani Cloderm 1%?
6. Informacione të mëtejshme

1. ÇFARË ËSHTË CLODERM 1% DHE PËRSE PËRDORET?

Kremi Cloderm 1% është një antimykotik me spektër të gjerë.
Cloderm 1% përdoret në infeksionet mykotike të lëkurës të shkaktuara nga dermatofitet, kërpudhat (p.sh. *Candida*), myqe dhe të tjerë si, *Malassezia furfur* si dhe në infeksionet e shkaktuara nga *Corynebacterium minutissimum.*
Këto mund të shfaqen si mykoza të këmbëve, mykoza të lëkurës dhe rrudhave të saj, pityriasis versicolor, eritrazma, kandidoza sipërfaqësore.

2. ÇFARË DUHET TË KINI KUJDES PËRPARA SE TË PËRDORNI CLODERM 1%?

Cloderm 1% nuk duhet të përdoret:

- nëse keni mbindjeshmëri (alergji) ndaj klotrimazolit ose ndonjërit nga përbërësit e tjerë të kremit Cloderm 1% të shënuar në pikën 6;
- nëse keni mbindjeshmëri ndaj alkoolit cetilstearilik; në këtë rast rekomandohet që në vend të kremit të përdoret një formë farmaceutike e cila nuk përmban alkool cetilstearilik.

Tregoni kujdes të veçantë gjatë përdorimit të Cloderm 1%
Flisni me mjekun apo farmacistin tuaj përpara se të përdorni Cloderm 1%.

Përdorimi i Cloderm 1% me barna të tjera
Ju lutemi të informoni mjekun ose farmacistin tuaj nëse merrni / përdorni, keni marrë / përdorur kohët e fundit ose keni ndërmend të merrni / përdorni barna të tjera, edhe nëse bëhet fjalë për barna që merren pa recetën e mjekut.
Klotrimazoli redukton efektin e amfotericinës dhe antibiotikëve të tjerë polienikë (nistatin, natamicin).

Shtatzënia dhe ushqyerja me gji
Nëse jeni shtatzënë apo ushqeni me gji, nëse dyshoni se jeni shtatzënë apo planifikoni një shtatzëni, kërkoni këshillën e mjekut ose të farmacistit përpara se të përdorni këtë bar.
Si masë përkujdesjeje, klotrimazoli nuk duhet përdorur në shtatzëninë e hershme.

Drejtimi i automjetit dhe përdorimi i makinerive
Nuk ka të dhëna lidhur me ndikimin në aftësinë për të drejtuar automjetin dhe për të përdorur makineri.

Informacione të rëndësishme për disa nga lëndët ndihmëse të Cloderm 1%
Kremi Cloderm 1% përmban alkool cetilstearilik dhe alkool benzilik.
Alkooli cetilstearilik mund të shkaktojë irritime lokale në lëkurë (p.sh. dermatit kontakti).
Alkooli benzilik mund të shkaktojë reaksione alergjike dhe irritim të lehtë lokal.

3. SI TA PËRDORNI CLODERM 1%?

Gjithmonë përdoreni Cloderm 1% sipas rekomandimit të mjekut ose farmacistit dhe udhëzimeve të këtij fletëudhëzuesi. Pyesni mjekun ose farmacistin tuaj nëse nuk jeni i sigurt.

Doza e zakonshme është:
Kremi aplikohet 2 – 3 herë në ditë në shtresë të hollë në zonën e sëmurë dhe masazhohet. Zakonisht mjafton një sasi e vogël kremi (shirit rreth ½ cm) për një zonë me sipërfaqe sa pëllëmba e dorës.

Kohëzgjatja e përdorimit
Që terapia të ketë sukses, është e rëndësishme që kremi të përdoret rregullisht dhe për një kohë të mjaftueshme. Kohëzgjatja e trajtimit është e ndryshme; ajo varet ndër të tjera nga përhapja dhe vendi i sëmundjes. Për të arritur një shërim të plotë, trajtimi me kremin nuk duhet të ndërpritet pas zhdukjes së simptomave inflamatore akute ose pas zhdukjes së ankesave subjektive, por duhet të vazhdojë për të paktën 4 javë.
Pityriasis versicolor shërohet përgjithësisht pas 1 – 3 javësh dhe eritrazma pas 2 – 4 javësh. Në mykun e këmbës, për të parandaluar recidivat, pavarësisht përmirësimit të shpejtë subjektiv, trajtimi duhet të vazhdojë rreth 2 javë pas zhdukjes së të gjitha shenjave të sëmundjes. Pas çdo larjeje, këmbët duhet të thahen mirë (hapësirat midis gishtave).

Nëse keni përdorur një sasi më të madhe Cloderm 1% se sa duhet
Mund të vazhdoni trajtimin me dozat e rekomanduara. Nuk priten efekte anësore nga mbidozimi afatshkurtër.

Nëse keni harruar të përdorni Cloderm 1%
Vazhdoni trajtimin me dozimin e përshkruar (mos e aplikoni kremin më shpesh ose në sasi më të mëdha).

Nëse ndërprisni përdorimin e Cloderm 1%
Kini parasysh se është e rëndësishme një kohëzgjatje e mjaftueshme e trajtimit me Cloderm 1% për të siguruar një shërim të plotë dhe shmangien e recidivave.
Flisni me mjekun ose farmacistin tuaj përpara se të ndërprisni trajtimin ose ta përfundoni atë para kohe, për shkak p.sh. të efekteve anësore!
Nëse keni pyetje të tjera mbi përdorimin e këtij bari, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.

4. CILAT JANË EFEKTET ANËSORE TË MUNDSHME?

Si të gjithë barnat, Cloderm 1% mund të ketë efekte anësore, por që mund të mos shfaqen tek kushdo.
Për vlerësimin e efekteve anësore janë përdorur treguesit e mëposhtëm të shpeshtësisë:

Shumë të shpeshta	më shumë se 1 pacient ndër 10
Të shpeshta	1 deri 10 pacientë ndër 100
Të pazakonta	1 deri 10 pacientë ndër 1.000
Të rralla	1 deri 10 pacientë ndër 10.000
Shumë të rralla	më pak se 1 pacient ndër 10.000
Të panjohura	Frekuenca nuk mund të vlerësohet në bazë të të dhënave që disponohen

Efekte të mundshme anësore:
Shpesh mund të ndodhin reaksione në lëkurë (p.sh. djegie, ndjenjë shpimi). Në rast mbindjeshmërie ndaj alkoolit cetilstearilik mund të shfaqen reaksione alergjike në lëkurë. Alkooli benzilik mund të shkaktojë reaksione alergjike dhe irritim të lehtë lokal.
Informoni mjekun ose farmacistin tuaj nëse ndonjë prej efekteve anësore ju shqetëson ose nëse vëreni efekte anësore që nuk përmenden në këtë fletëudhëzues.

5. SI TA RUANI CLODERM 1%?

Ruajeni barin larg fëmijëve!
Ruajeni nën 25°C!
Nuk duhet ta përdorni barin pas datës së skadencës të shënuar në tubet dhe në kuti.

6. INFORMACIONE TË MËTEJSHME

Çfarë përmban Cloderm 1%:
Lënda aktive është klotrimazol.
1 g krem përmban 10 mg klotrimazol.
Lëndët ndihmëse janë: 2-oktil-1-dodekanol, alkool cetilstearilik, cetilpalmitat, polisorbat, sorbitan stearat, alkool benzilik, PEG – stearat – glikol stearat, ujë i pastruar.

Përmbajtja e paketimit
Kuti me një tubet me 30 g.

Mbajtësi i Autorizimit për Tregtim dhe Prodhuesi

PROFARMA sh.a.,
Rruga "Skënder Vila",
Tiranë, Shqipëri.
Tel.: +355 4 23 89 602

Ky fletudhëzues u rishikua për herë të fundit në Nëntor 2023.

SPECIFICATION

CROPING AREA 12 x 19 cm

PAY ATENTION, all the layers are visible.
If you have to print this document please check or uncheck the specific layers.